



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 156 Datë 28.12.2020

“Për Përdorimin e Fondit të Emergjencave Civile, nga Granti & Të Ardhurat”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.140 datë 26.12.2019, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.16/1 prot. datë 17.01.2020, ligji nr.45 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe VKM 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, kërkojmë që të përdoret fondi emergjencave civile për raste fatkeqësish dhe dëmtim shtëpie sipas projektit të dorëzuar nga Drejtoria e Planikimit Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave: Këshilli Bashkisë,në mbledhjen e tij, **datë 28.12.2020 miratoi me 18 vota pro 0 kunder 0 apstenim.**

VENDOSI :

1. Nga fondi i emergjencave civile dhe fondi i kontigjencës, Granti dhe të Ardhurat janë planifikuar në buxhetin e Bashkisë Dibër vlera 20,277,200 lekë, të përdorura janë në vlerën 11,251,582 lekë, mbetën për tu përdorur 9,247,179 lekë, t'i jepet ndihmë për raste dëmtim shtëpie :
2. Remzi Halit Deshati shuma prej 66 745 lekë
3. Osman Halit Deshati shuma prej 13 513 lekë
4. Pakësohet fondi emergjencave civile **1810** në vlerën **80 258** lekë dhe shtohet struktura **1110** llogaria **604** në vlerën **80 258** lekë.
5. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e PPECK dhe Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

